IOM International Organization for Migration
OIM Organisation Internationale pour les Migrations
OIM Organización Internacional para las Migraciones

# Raporti i parë statistikor mbi profilin e klienteve të Qëndrave të Shërbimit për Migrantët/Sporteleve të Migracionit

## (Ngritja e Kapaciteteve, Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimit për Nxitjen e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perendimor)

**Qershor – Gusht 2008**

## Sfondi i projektit:

Qendrat e Shërbimit për Migrantët veprojnë në Shqipëri (ku quhen Sportelet e Migracionit), Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë, Mal të Zi, dhe Serbi duke i ofruar migrantëve asistencë të individualizuar dhe këshillim mbi realitetin dhe rreziqet e migracionit të parregullt dhe mundësitë/procedurat për punësim në vend dhe/ose për migracion të rregullt. Qendrat e Shërbimit për Migrantët/Sportelet e Migracionit ofrojnë gjithashtu edhe shërbime referimi tek institucionet përkatëse vendore lidhur me zhvillimin e aftësive individuale, në funksion të shtimit të mundësive të punësimit si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Qendrat e Shërbimit për Migrantët janë pjesë e projektit "Ngritja e Kapaciteteve, Rritja e Shkalles së Informimit dhe Ndërgjegjësimit për Nxitjen e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit AENEAS 2006, nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshteinit.

Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit: http://www.migrantservicecentres.org

## Përmbledhje Statistikore:

Numri total i klientëve të rregjistruar pranë këtyre qendrave gjatë tremestrit të pare të veprimtarisë së tyre (qershor-gusht 2008) është 1003, nga një numër total vizitash prej 1012. Pjesa më e madhe e klientëve janë vendas, dhe një përqindje e vogël janë imigrantë në këto vende (6.7%).. Përmbledhja e mëposhtme i referohet vetëm rasteve të vendasve dhe pasohet me një përmbledhje të rasteve te imigranteve në pjesën e dytë.

### 1. Vendasit

Numri më i madh i vizitoreve është regjistruar në Kosove, Maqedoni dhe Shqipëri. 75% e klientëve janë meshkuj kryesisht në moshën 30-35 vjeç. Pjesa më e madhe e klientëve vijnë nga zonat urbane.

Të papunët përbënin një pjesë të madhe të klientëve të QSHM-ve (61%). Është paraqitur gjithashtu një shifër e lartë e sektorëve të punësimit.

Më shumë se gjysma e vizitorëve kanë emigruar më parë. Pjesa me e madhe e klientëve që kishin emigruar më parë kishin aplikuar për azil ose për punë. Gjermania, Greqia, dhe Zvicra ishin ndër vendet më të kërkuara.

Pjesa më e madhe e klientëve të interesuar për migracion me motive punësimi deklarojnë Kanadanë, Italinë, Gjermaninë, SHBA dhe Australinë si vendet e preferuara të destinacionit.

Asistenca e ofruar nga punonjësit e QSHM-ve ishte kryesisht dhenie informacioni (84%) e ndjekur nga këshillimi dhe referimi që zënë respektivisht 10% and 6% të shërbimit

## Nr i visitorëve sipas shteteve:




## Mosha mesatare sipas shteteve:




## Gjinia:




## Gjendja Civile:



## Vendbanimi:




## Numri i familjarëve në ngarkim




## Niveli arsimor:



## Gjendja e Punësimit:




## Sektori i Punësimit:




## Migruar më parë:




Numri i herëve
2%
3%
6%
16%
73%
Një herë
Dy herë
Tre herë
Katër herë
5 herë e më shumë


Tipi i Migracionit
180
160
140
120
100
80
60
40
20
0
168
156
114
31
6
6
Azil
Punë
Tjetërr
Studime
Bashkim familjar
Biznes


10 Shtetet më të preferuara të destinacionit
140
120
100
80
60
40
20
0
118
37
34
27
24
22
15
15
15
13
Gjermani
Itali
Greqi
Zvicër
Shqipëri
maqedonia
SHBA
Turqi
Serbia
Sllovenia

**Planet për të migruar:**






**Lloji i asistences që ofrohet nga QSHM-të:**




## 2. Imigrantë

Numri total i Migrantëve të rregjistuar pranë QSHM-ve ishte 68. Numri më i madh i vizitorëve imigrantë është rregjistruar në Shqipëri, Mal të Zi dhe Kroaci. Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk kanë pasur kërkesa për imigrantë.

Shumica e imigrantëve janë të punësuar dhe janë pajisur me leje pune.










Statusi në vendin pritës
45
40
35
30
25
20
15
10
5
0
42
7
7
5
2
2
1
Leje pune
Martuar me vendas
Tjetër
Pa status legal
student i huaj
leje përkohshme
bashkim familjar


Gjendja Civile (imigrantë)
3%
3%
34%
60%
martuar
beqar
i/e ve
tjeterr


Niveli arsimor (imigrantë)
5%
6%
11%
44%
34%
9 Vjecar
Universitet
E mesme
Fillore
S'ka